



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E
MINIERAVE DHE INDUSTRIËS

Nr. 5773/Prot.

Tiranë, më 29.7.2026

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1197/1, datë 01.07.2008.

SHOQËRISË “IHD” SH.P.K
Rr. “Drenova”, Godinë private nr.11 , Kati 4, Tiranë

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË
MINIERA

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë

Shoqëria “IHD” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1197/1, datë 01.07.2008, për mineralin krom, në Objektin “Pika 142, Almarinë”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 3726 prot., datë 08.07.2026, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 5773 Prot., datë 09.07.2026, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1197/1, datë 01.07.2008, për mineralin krom, në Objektin “Pika 142, Almarinë”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, pasi në objekt nuk punohet prej më shumë se një viti kalendarik. Gjithashtu, sipas të dhënave të AKBN-së rezulton se subjekti nuk ka mbrojtur planin vjetor të punës për vitet 2025-2026 dhe 2026-2027.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “c” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minërar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minërar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr. 1197/1, datë 01.07.2008, për mineralin krom, në Objektin “Pika 142, Almarinë”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 “Procedura e revokimit të lejes”, keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Nr.1197/1, datë 01.07.2008, për mineralin krom, në Objektivin “Pika 142, Almarinë”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 “Procedura e revokimit të lejes”, të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
ENEA KARAKAÇI
ME URDHËR PËR DELEGIM
ZËVENDËSMINISTRI
ERLIND SULO

A large, stylized handwritten signature in blue ink is written over a circular official stamp. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRISE" at the top, "MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË" around the sides, and "TIRANË" at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Albania.